

RREGULLORE E LOJËS PROMOCIONALE

1. Organizatori i lojës promovionale

- Organizatori i lojës promovionale është "**Alcedrix Albania**" shpk Dege e shoqërisë së huaj, rregjistruar si i tillë pranë Regjistrimit Tregëtar në QKB, pajisur me Nipt **M21827004A** dhe seli në Rruga Peti, Pallati Nr. 1, Kati 0. Me përfaqësues ligjor Z.Durim Emini, i biri i Skenderit, i datëlindjes. 04.09.1982, i lindur në Prishtinë. Madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi nr. Personal 1001160504 lëshuar më datë 16.05.2017.
- Shoqëria "Alcedrix Albania" sh.p.k ka në objektin e saj të veprimtarisë "Tregëti me shumicë e artikujve farmaceutike, Aktivitete të keshishillirnit për biznes dhe keshillat e tjera për manaxhim. Agjencite për publicitet, Tregtia me pakice e artikujve farmaceutike në dyqane të specializuara Si përfaqësuese e ligjshme e rrjetit Big Market, shoqëria "Alcedrix Albania" sh.p.k organizon lojën promovionale

2. Kohëzgjatja

- Kohëzgjatja e lojës promovionale do të jetë për një periudhë nga data 15 Qershor 2024 dhe do të përfundojë në 30 Shtator 2024.
- **Mekanizmi për të marrë pjesë në lojën promovionale**
- "Të gjithë konsumatorët mbi 18 vjeç, të cilët bëjnë një blerje për produktet:

PRODUKTI	CMIMI PA TVSH	CMIMI ME TVSH
ABSOLUTE DRY - TORR 35ML	ALL 1,658.33	ALL 1,990.00
WORKING HANDS POMADE 96g O`KEEFFE`S	ALL 1,491.67	ALL 1,790.00
WORKING HANDS TUBETE 60g O`KEEFFE`S	ALL 1,325.00	ALL 1,590.00
HEALTHY FEET POMADE 91g O`KEEFFE`S	ALL 1,491.67	ALL 1,790.00

HEALTHY FEET TUBETE 60g O`KEEFFE`S	ALL 1,325.00	ALL 1,590.00
LIP REPAIR 4.2g PA SHIJE O`KEEFFE`S	ALL 816.67	ALL 980.00
LIP REPAIR SPF 4.2g O`KEEFFE`S	ALL 816.67	ALL 980.00

në të gjitha farmacit partnere, te cilat kanë të drejtën të marrin pjesë në lojën promovionale. Shorteu do të fillojë me datë 15.06.2024 dhe do të përfundojë me date 30.09.2024. Çdo konsumator mund të marrë pjesë në lojë duke plotësuar të dhënat e tij të sakta (emër, mbiemër dhe Nr. Telefoni) në kuponin tatimor që do të jepet në kasë. Pas shënimit të kontakteve të klientit, kuponi fiskal duhet të vendoset brenda kutisë së posaçme e cila do të hapet vetem në ditën e tërheqjes së shorteut.

3. Shtrirja e Lojës Promovionale

Loja Promovionale do të zhvillohet në të gjithë rrjetin e farmacive partnere në të gjithë republikën e Shqipërisë. Objektivi është që maksimalisht të jenë 200 pika partnere.

4. Çmimet që do të jepen në Lojën Promovionale

Çmimet që do të shpërndahen gjatë zhvillimit të kësaj loje promovionale nga "Alcedrix Albania" janë:

- Në shortin e **1-rë** të datës **04.10.2024** ora 11:00 am, në zyrat qendrore "Alcedrix Albania", do të shpallen fituesit për 50 (pesëdhjetë) dhuratat: 2(dy) iPhone 15; 1(një) Sony PlayStation; 1(një) Trotinet; 3(tre) Rrobalese; 3(tre) Tablet Samsung; 3(tre) TV LG 55inch; 3(tre) SoundBar Sony; 3(tre) Fritez Philips; 3(tre) Aparat kafe Beko; 3(tre) Fshese robotike xianomi; 3(tre) Fshese elektrike Beko; 3(tre) Hekur me avull Philips; 3(tre) Philips Juicer; 3(tre) Tharese per floke; 5 (pesë) Kufje JBL ; 5 (pesë) Kufje JBL dhe 3 (tre) Udhëtime në çift (në njërin nga destinacionet: Paris, Barcelone ose Rome)
- Në shortin e **2-të** të datës **04.10.2024** ora 13:00 pm, në zyrat qendrore "Alcedrix Albania", do të shpallen fituesit për 5 (pesë) Udhëtime në çift (në njërin nga destinacionet: Paris, Barcelone ose Rome)

Nr. Shortit	Nr	Çmimi	Fitues
Shorti 1-rë	1	2(dy) iPhone 15	2
	2	1(një) Sony PlayStation	1
	3	1(një) Trotinet Segëay ninebot	1
	4	3(tre) Rrobatarese Beko	3
	5	3(tre) Tablet Samsung	3
	6	3(tre) TV LG 55inch	3
	7	3(tre) SoundBar Sony	3
	8	3(tre) Fritez Philips	3
	9	3(tre) Aparat kafe Beko	3
	10	3(tre) Fshese robotike xianomi	3
	11	3(tre) Fshese elektrike Beko	3
	12	3(tre) Hekur me avull Philips	3
	13	3(tre) Philips Juicer	3
	14	3(tre) Tharese per floke	3
	15	5 (pesë) Kufje JBL	5
	16	5 (pesë) Kufje JBL	5
	17	3 (tre) Udhëtime në çift (në një nga destinacione sipas preferencave: Paris, Barcelone ose Rome)	3
Shorti 2-të	1	5 (pesë) Udhëtime në çift (në një nga destinacione sipas preferencave: Paris, Barcelone ose Rome)	5

5. Vlefshmëria e pjesëmarrjes në lojë

- Çdo konsumator mund të marrë pjesë në lojë duke plotësuar të dhënat e tij të sakta (emër, mbiemër dhe Nr. Telefoni) në kuponin fiskal që do të jepet në kasë.
- Në total Alcedrix Albania do të dhurojë 50 dhurata në përfundim të kësaj Loje Shpërblyese. Do të fillohet nga çmimi më i vogël deri në çmimin më të madh, edhe atë duke i informuar gjithnjë shikuesit se për cilin shpërblim po bëhet tërheqja e kuponit të rradhës
- Çmimet e Shorteu promocional janë të patransferueshme pavarësisht çdo rrethane apo situatë Alcedrix Albania mund të refuzojë dhënien e cmimit/cmimeve në rast se ajo konstaton

se nuk janë respektuar kushtet e kësaj Rregulloreje, apo në rast se fituesit rezultojnë të tillë si rezultat i ndonjë parregullesie apo mashtrimi.

- Brenda 2 ditëve pune nga gjenerimi i fituesve nga hedhja e shorteut, numrat e telefonit fitues do të lajmërohen me anë të SMS dhe ku do të informohen që janë fitues të Shorteu promocional. Fituesit do të kontaktohen edhe me telefon nga kompania Alcedrix Albania ku do të kërkohen edhe detajet identifikuese. Fituesi do të kontaktohet te pakten tre (3) here me telefon dhe në rast se nuk përgjigjet do të procedohet me një numër tjetër fitues si zëvendësues. Klienti fitues mund të paraqitet pranë marketit ku ka bërë blerjen brenda 30 ditëve pas shpalljes fitues.
- Për të tërhequr çmimin, fituesit duhet të paraqiten në zyrat qendrore të Alcedrix Albania. Në momentin e paraqitjes për tërheqjen e çmimit, fituesit do t'ju kërkohet të japin të dhënat e tyre ose shoqëruesit në rast kur është i mitur të cilat janë: Emër, Mbiemër, Datëlindje, kopjen e kartës së identitetit dhe/ose i pasaportës si dhe adresa e banimit. Fituesi duhet të ketë me vete edhe numrin e telefonit me të cilin është kontaktuar për t'u njoftuar se ka fituar.
- Nëse fituesi nuk paraqitet për të tërhequr çmimin brenda dy (2) ditëve nga momenti i njoftimit, Alcedrix do të kontaktojë fituesin nëpërmjet telefonit për ti rikujtuar çmimin që ka fituar nga Loja Shpërlyese. Nëse fituesi nuk paraqitet ditën e njoftimit apo nuk përgjigjet do të procedohet me një numër tjetër fitues si zëvendësues.

6. Procedura e hedhjes së shorteut

- Të gjithë kuponat blerjeve do të mblidhen në kutitë e vendosura në Zyrat Qendrore të shoqërisë "Alcedrix Albania" sh.p.k ku dhe do të hidhet shorteu sipas datave të përcaktuara më sipër në orën 11:00 am.
- Fituesit do të zgjidhen për secilin çmim në bazë të renditjes rastësore duke u tërhequr kuponi fiskal në mënyrë manuale pashikuar tek kutija e të gjithë kuponëve.
- **Rradha e përzgjedhjes** së fituesve do të fillojë nga çmimet e vogla deri tek më të mëdhatat, sipas rradhës në pikën 5.
- Kuponat Fiskal të cilët përzgjidhen u lexohen të dhënat emër mbiemër dhe çmimi i fituar.
- Fituesit do të njoftohen në telefon në numrin e kontaktit të vendosur në kupon, nga punonjësit e Alcedrix Albaia", pas përfundimit të hedhjes së shorteut.
- Emrat e fituesve do të publikohen në faqet zyrtare të mediave sociale të shoqërisë "Alcedrix Albania" sh.p.k dhe në faqen zyrtare të internetit.

- Në rast se kontakti nuk është i saktë, të dhënat do të verifikohen nga data baza e brendshme që ka shoqëria “Alcedrix Albania” sh.p.k për klientët e saj.

7. Përdorimi i të dhënave të klientëve

- Me vendosjen e Kuponave Fiskal në kutinë e shorteut, pjesëmarrësit kanë dhënë miratimin e tyre për përdorimin e të dhënave të tyre personale për këtë lojë dhe përfshirjen në këtë lojë, duke pranuar automatikisht rregullat dhe mekanizmin e Lojës Promocionale
- Shoqëria vërteton se të dhënat e klientëve të shënuara në kuponat e shorteut do të ruhen sipas legjislacionit në fuqi dhe do të përdoren vetëm për qëllimin e realizimit të lojës promocionale dhe njoftimin e fituesve.

8. Tërheqja e dhuratave të shorteut

- Për të tërhequr dhuratën, fituesit duhet të paraqiten në zyrës qendrore të Alcedrix Albania. Në momentin e paraqitjes për tërheqjen e cmimit, fituesit do t’ju kërkohet të japin të dhënat e tyre të cilat janë: Emër, Mbiemër, Datëlindje, kopjen e kartës së identitetit dhe/ose i pasaportës si dhe adresa e banimit. Fituesi duhet të ketë me vete edhe numrin e telefonit me të cilin është kontaktuar për t’u njoftuar se ka fituar. Nëse fituesi nuk paraqitet për të tërhequr cmimin brenda dy (2) ditëve nga momenti i njoftimit, Alcedrix do të kontaktojë fituesin nëpërmjet telefonit për ti rikujtuar cmimin që ka fituar nga Loja Shpërlyese. Nëse fituesi nuk paraqitet ditën e njoftimit apo nuk përgjigjet do të procedohet me një numër tjetër fitues si zëvendësues.
- Në rast se ndodh vdekja e ndonjërit prej personave të cilët shpallen fitues, ka të drejtë të tërheqë çmimin një person tjetër i familjes së tij, i pajisur me certifikatë familjare dhe certifikatë vdekje të personit të shpallur fitues.
- Me pranimin e paktës së shorteu promocional, fituesit kanë dhënë miratimin që emri dhe imazhi i tyre mund të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Alcedrix dhe në faqet zyrtare që Alcedrix ka në rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe Tik tok. Gjithashtu fituesit, i jep të drejta të plota Alcedrix lidhur me përdorimin e të drejtave të imazhit të tyre në fotografitë, videot (ose cdo version të tyre që ka prezencën e tyre) të cilat do të shfaqen në publik në kuadrin e fushatave promocionale aktuale apo të ardhshme të Alcedrix Albania sh.p.k.
- Për dorëzimin e dhuratave do të mbahen 3 (tre) kopje të proçes-verbalit të dorëzimit ku dy kopje i mban shoqëria dhe një kopje e mban fituesi i dhuratës.

9. Përfaqësuesit e lojës promovionale

- Sipas legjislacionit në fuqi, gjatë hedhjes së shortit sipas datës të përcaktuar më sipër në ambientet e shoqërisë “Alcedrix Albania” sh.p.k do të jenë të pranishëm: një përfaqësues nga Drejtoria e Tatimeve Tiranë, një përfaqësues nga Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit, një Noter dhe një përfaqësues nga shoqëria “Alcedrix Albania” sh.p.k e cila zhvillon shorteun.
- Shorteu do të transmetohet live (**livestream**) në rrjetet sociale të Alcedrix Albania
- Komunikimi i Shorteu promovional do të bëhet nëpërmjet kanaleve të komunikimit që Alcedrix ka në dispozicion si WEB faqen zyrtare, radio, media dixhitale, print dhe komunikim në dyqane partnere